



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo Qeveria e Kosovës - Vlada Republika - Government of Kosovo MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIE - MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE - MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY			
Nr. Sht. Org. Org. Ujedn. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	414
Nr. i Faqeve Stranica No pages	2	Data Datum Date	31.12.09

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije- Ministry of Trade and Industry

Në bazë të nenit 93 (4) të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 8.4 të Ligjit Nr.03/L-031 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 02/L-5 “Për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme”, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 2009/27

**PËR RREGULLIMIN E LOGOS, VULËS SE AGJENCISË PËR
MBËSHTETJEN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME SI DHE
PËRDORIMI I TYRE**

Neni 1
Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ përcakton formën, përmbajtjen e logos dhe vulës së Agjencisë për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla apo të mesme, që vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Neni 2
Përkufizimet

Në kuptim të këtij Udhëzimi termat e përdoruar në vijim kanë këto kuptime.

NMVM - nënkupton ndërmarrjet mikro të vogla apo të mesme.


Logo - nënkupton logon e Agjencisë për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla apo të mesme.

Vula - nënkupton vulën e Agjencisë për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla apo të mesme.

Neni 3

Logo

1. Logo e Agjencisë, përmban përshkrimin e tekstit në gjuhë zyrtare.
2. Logo e Agjencisë duket.



AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E NVM-ve
AGENCIJA ZA PODRŠKU MSP-a
SME's SUPPORT AGENCY

3. Logo përdoret në të gjitha dokumentet dhe shkresat zyrtare të Agjencisë.

Neni 4

Vula

Në bazë të Ligjit nr.03/L-054 neni 3 për vulat në Institucionet e Republikës së Kosovës, Agjencia i bënë kërkesë Ministrisë së Administratës Publike për pajisje me vulë.

Neni 5

Zbatimin dhe mbikëqyrjen e këtij Udhëzimi Administrativ e benë Agjencia e NMVM-vë

Neni 6

Hyrja ne fuqi

Ky Udhëzim administrativ hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Tregtisë dhe Industrisë.

Prishtinë, 31.12.2009

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë
Lutfi ZHARKU

